

Konkluzionet e lehtësuesit të BE mbi implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013

Në mënyrë që të implementohen obligimet nën 'Aranzhimet për energji' të nënshkruar nga dy Kryeministrat në shtator 2013, të dy palët pajtohen për si vijon:

Themelimi i kompanisë së re tregtare

1. Kosova do të lejoj EPS që të themeloj një kompani tregtare për energji në Kosovë, në pajtim me obligimet e mos diskriminimit nën Komunitetin e Energjisë dhe në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
2. EPS do të dorëzoj dokumentet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për të aplikuar për certifikatën e regjistrimit para fundit të **Gushtit 2015**.
3. Në pajtim me rregullat dhe afatet e vetë Kosovës, kjo certifikatë e regjistrimit do të lëshohet brenda 7 ditëve.
4. Kjo kompani do të aplikoj për, dhe do t'i jepet një licencë e cila mbulon importin, eksportin dhe transitin.

Themelimi i kompanisë së re për furnizim dhe shërbimet shpërndarjes

5. Kosova do të lejoj EPS që të themeloj një kompani furnizimi në Kosovë, në pajtim me obligimet e veta për mos diskriminim nën Komunitetin e Energjisë dhe në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të Kosovës.
6. EPS do të dorëzoj dokumentet në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë për të aplikuar për certifikatën e regjistrimit para fundit të **Gushtit 2015**.
7. Në pajtim me rregullat dhe afatet e vetë Kosovës, kjo certifikatë e regjistrimit do të lëshohet brenda 7 ditëve.
8. Emri i kësaj kompanie do të jetë 'ElektroSever'.

Licenca e furnizimit

9. Kjo kompani do të aplikoj në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ) për licencat e nevojshme për të furnizuar konsumatorët, për të blerë dhe shitur energji në tregun e hapur dhe të importoj dhe eksportoj energji. Kjo licencë do të jepet në pajtim me kornizën ligjore dhe rregullatore të vetë Kosovës.
10. Licenca e furnizimit do të jetë operative kur KOSTT të bëhet anëtarë i ENTSO-E.
11. ElektroSever do të nënshkruaj marrëveshje me KOSTT në mënyrë që të merr pjesë në tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe të bëhet palë përgjegjëse për balancim.
12. ElektroSever do të ketë të drejtë që të bëjë faturimin dhe arkëtimin, pasi që këto janë aktivitete normale për një kompani të furnizimit.
13. Do të sigurohet qasja në infrastrukturën e transmisionit dhe distribucionit për KOSTT, KEDS dhe ZRRÉ si dhe të dhënat e konsumatorëve. Këto të dhëna do të ofrohen nëpërmjet BE.

14. ElektroSever do të hyjë në diskutime me KEDS dhe KOSTT, për të siguruar qasjen e palës së tretë.

Shërbimet e distribucionit

15. Të dy palët do të vazhdojnë të punojnë, me lehtësimin e BE, me qëllim që të lejojnë ElektroSever që të ofroj shërbimet e distribucionit të bazuara në parimet e 'Aranzhimeve për Energji'.

Çështjet tjera

16. Serbia, dhe EMS do të mbështesin aplikacionin e KOSTT për të nënshkruar një marrëveshje interkonjeksioni me ENTSO-E, përfshirë edhe procesin e apelit.

17. Të dy palët pajtohen se të gjitha pikat e këtyre konkluzioneve do të implementohen pavarësisht nga progresi në pikën 15.

Mohimi

Kosova konsideron se, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës, dhe ligjin ndërkombëtar, përkatësisht UNSCR 1244 dhe Rregulloret përkatëse të UNMIK, prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Republikës së Kosovës.

Serbia konsideron se, në pajtim me ligjin vendor dhe ndërkombëtar, përkatësisht UNSCR 1244, prona brenda territorit të Kosovës është në pronësi të Serbisë, sipas rregullimit specifik provincial dhe në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën e Serbisë.